

VENDIM
Nr. 612, datë 17.9.2014

**PËR RIORGANIZIMIN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MBRETËRINË E BELGJIKËS DHE TË MISIONIT TË PËRHERSHËM TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË BASHKIMIT EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 23, të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Riorganizimin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian.
 2. Bashkimin e funksioneve të kreut të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian.
 3. Emërtimi i Misionit Diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës, të jetë: “Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian”.
 4. Vendimi nr. 142, datë 3.3.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës”, shfuqizohet.
 5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama